

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke e konsideruar Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik përmes një administrate të përgjegjshme, e cila mirëmenaxhon fondet publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke vlerësuar si një arritje tepër të rëndësishme implementimin e reformës së digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe minimizimin e korrupsionit;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2023 dhe vlerëson:

Uljen e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit në masën 9.4 %, nga 10.1% në vitin 2022 dhe 10.8 % që ishte në vitin 2021.

Uljen e kohës së vendimmarrjes për vitin 2023 në 10 ditë krahasuar me kohën e vendimmarrjes për vitin 2022, e cila ishte 12 ditë.

Uljen e numrit të vendimeve të ankimuara pranë Gjykatës Administrative, nga 5.5 % të vendimeve të ankimuara në vitin 2022, në 4.4 % të vendimeve të ankimuara në vitin 2023.

Organizimin e seancave dëgjimore përmes një sistemi audio të lidhur me Sistemin e Ankesave Elektronike.

Referimin drejt Agjencisë së Prokurimit Publik për hetim administrativ për raste të konstatuara në shkelje në procedurat e prokurimit publik nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Angazhimin në ndërtimin e një sistemi ankesash elektronike, me përdorimin e teknologjisë (e-ankesa).

Publikimin e buletineve mujore gjatë gjithë vitit 2023 në kuadër të transparencës.

Publikimin e informacioneve të vazhdueshme në faqen zyrtare të KPP-së lidhur me vendime, aktivitete, marrëveshje etj.

Përdorimin intensiv të teknologjisë së nënshkrimit elektronik në kuadër të Sistemit të Ankesave Elektronike, e cila ka shënuar një ndryshim themelor në procesin e dorëzimit dhe shqyrtimit të dokumenteve.

Bashkëpunimet e ndryshme me partnerë shqiptarë dhe ndërkombëtarë në kuadër të modernizimit dhe forcimit të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri.

Masat e ndërmarra nga KPP-ja për informimin e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore mbi momentin procedural të fillimit të afateve të ankimit, si me anë të publikimit në faqen zyrtare të procedurave të ankimit referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ashtu edhe me publikimin e njoftimit për marrjen e vendimeve interpretuese në përputhje me nenin 24, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Publikimin e vendimeve interpretative gjatë vitit 2023, sipas parimit të “Open Data”, në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, në seksionin “Institucioni”, “Buletini mujor”.

Krijimin e pyetësorit rreth Sistemit të Ankesave Elektronike dhe Veprimtarisë së KPP-së në kuadër të parimeve të mirëqeverisjes, me target autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë, si dhe subjekte të tjera të interesuara.

Miratimin e strukturës për vitin 2023 me vendimin nr. 112/2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 65/2020 ‘Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik’”, i ndryshuar.

Kuvendi kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik të angazhohet veçanërisht edhe në këto aspekte të veprimtarisë së tij për vitin 2024:

1. Të rishikohen kriteret e përzgjedhjes së pozicioneve vakante, me qëllim plotësimin e strukturës administrative dhe funksionimin me eficiencë të institucionit.
2. Të vijojë angazhimin për informimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore për procedurat apo format e plotësimit të dokumentacionit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të hartojë manuale të përditësuara mbi përdorimin e sistemit elektronik të prokurimit publik dhe të procedurave në të gjitha fazat e procesit të prokurimit.
3. Të angazhohet në realizimin e objektivave si anëtar themelues i Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Evropës Juglindore nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me vendet anëtare të rrjetit, evidentimit të problematikave në sistemin e rishikimit administrativ dhe përmirësimit të tyre përmes bashkëpunimit.
4. Të angazhohet në realizimin e objektivave si vend me status vëzhguesi të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Bashkimit Evropian.
5. Të bashkëpunojë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar më 18.12.2023 midis Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
6. Të jetë e kujdesshme në planifikimin dhe kërkesat buxhetore vjetore, në mënyrë që buxheti vjetor të realizohet në përputhje me kërkesat.
7. Të angazhohet në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publiko-privat.
8. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 26.7.2024.